

VENDIM
Nr. 642, datë 16.10.2024

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË PROJEKTIT NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE KONFEDERATËS
ZVICERANE, PËRFAQËSUAR NGA SEKRETARIATI SHTETËROR PËR
ÇËSHTJET EKONOMIKE, QË VEPRON NËPËRMJET AMBASADËS SË ZVICRËS
NË SHQIPËRI, PËR OFRIMIN E ASISTENCËS TEKNIKE PËR FORCIMIN E
MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE NË NIVEL VENDOR NË SHQIPËRI,
FAZA 2**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së projektit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike, që vepron nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për ofrimin e asistencës teknike për forcimin e menaxhimit të financave publike në nivel vendor në Shqipëri, faza 2, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MARRËVESHJE PROJEKTI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE KONFEDERATËS
ZVICERANE TË PËRFAQËSUAR NGA SEKRETARIATI SHTETËROR PËR ÇËSHTJET
EKONOMIKE, DUKE VEPRUAR NËPËRMJET AMBASADËS SË ZVICRËS NË
SHQIPËRI PËR OFRIMIN E ASISTENCËS TEKNIKE PËR FORCIMIN E
MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE NË NIVEL VENDOR NË SHQIPËRI
FAZA 2

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Konfederata Zvicerane,
në zbatim të Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik, Financiar dhe Humanitar, të lidhur dhe nënshkruar në Tiranë më 11 maj 2007 dhe të ratifikuar nga Parlamenti i Shqipërisë me ligjin nr. 9801, datë 13 shtator 2007;

me dëshirën për të forcuar marrëdhëniet e tyre dhe bashkëpunimin e frytshëm ndërmjet dy vendeve;

me qëllim nxitjen e zhvillimit të mëtejshëm ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Shqipërisë;

duke njohur angazhimin e Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë për vijimin e reformave, që synojnë krijimin e ekonomisë së tregut në kushte demokratike dhe sigurimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, kanë rënë dakord për termat dhe kushtet e përcaktuar më poshtë:

Neni 1 **Përkufizime**

Në këtë Marrëveshje Projekti, termit në vijim kanë kuptimet e mëposhtme, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe:

- a) “Palët Kontraktuese” nënkupton Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Konfederata Zvicerane, e përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike, duke vepruar nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri;
- b) “Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë” nënkupton Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave;
- c) “MF” nënkupton Ministrinë e Financave;
- d) “Konfederata Zvicerane” përfaqësohet nga Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike;
- e) “SECO” nënkupton Sekretariatit e Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike të Konfederatës Zvicerane;
- f) “Kontribut” nënkupton kontributin e pakthyeshem në natyrë, të ofruar nga SECO-ja sipas Marrëveshjes së Projektit;
- g) “Marrëveshje Kuadër” nënkupton Marrëveshjen ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik, Financiar dhe Humanitar, të lidhur dhe të nënshkruar më 11 maj 2007 dhe të ratifikuar nga Parlamenti i Shqipërisë me ligjin nr. 9801, datë 13 shtator 2007;
- h) “Agjenci zbatuese” nënkupton konsorciumin e drejtuar nga GFA Consulting Group GmbH;
- i) “MFP” nënkupton Menaxhimin e Financave Publike;
- j) “Projekt” nënkupton projektin “Forcimi i Menaxhimit të Financave Publike Vendore në Shqipëri”, faza 2;
- k) “Marrëveshje Projekti” (MP) nënkupton këtë marrëveshje që përcakton të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese, në lidhje me Projektin, në vijim e referuar edhe si “MP”;
- l) “Politikë e Auditimit Financiar të SECO-s” nënkupton udhëzuesit për auditimet e projekteve të financuara nga SECO;
- m) “TVSH” nënkupton tatimin mbi vlerën e shtuar;
- n) “SASPAC” nënkupton Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;
- o) “Autoritetet tatimore dhe doganore” nënkupton Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Neni 2 **Objektivi dhe objekti i Projektit**

2.1 Objektivi i përgjithshëm i Projektit është përmirësimi i mjedisit të menaxhimit të financave publike vendore (MFP) në Shqipëri, duke forcuar disiplinën financiare, duke rritur efikasitetin e përdorimit të burimeve publike dhe duke përmirësuar ofrimin e shërbimeve publike vendore.

Rezultatet specifike të këtij Projekti janë si vijon:

- Përmirësimi i planifikimit strategjik dhe i menaxhimit të përgjithshëm të buxhetit në 61 bashkitë e vendit;
- Fuqizimi i sistemeve dhe i proceseve të menaxhimit të të ardhurave vendore dhe kontributi për rritjen e të ardhurave të veta në bashki;
- Ngritja e sistemeve të efektshme për kontrollin e brendshëm, auditimin e brendshëm dhe raportimin financiar në nivel vendor;
- Fuqizimi i shkëmbimit të njohurive ndërmjet bashkive dhe përmirësimi i aftësive drejtuese dhe menaxhimit të ndryshimit të zyrtarëve kyç;

- Kapacitete më të mira të MF-së për mbikëqyrjen, bashkërendimin dhe monitorimin e proceseve vendore të MFP-së.

Projekti përbëhet nga 3 komponentë:

- Komponenti 1 – Mbështetja për bashkitë lidhur me përmirësimin e kapaciteteve dhe të sistemeve të tyre të MFP-së;

- Komponenti 2 – Nxitja e shkëmbimit të njohurive mbi MFP-në ndërmjet bashkive dhe fuqizimi i menaxhimit të ndryshimit dhe i kompetencave të udhëheqjes;

- Komponenti 3 – Forcimi i kapaciteteve të MF-së për trajtimin e MFP-së në nivel vendor.

Shtojca 1 paraqet bashkëlidhur një përshkrim të Projektit.

Neni 3

Shuma dhe përdorimi i kontributit

3.1 SECO-ja pranon të vendosë në dispozicion një kontribut të pakthyeshem në natyrë me shumë maksimale totale deri 4.493.050 (katër milionë e katërqind e nëntëdhjetë e tre mijë e pesëdhjetë franga zvicerane) për zbatimin e Projektit.

3.2 Kontributi i nënshtrohet miratimit të shumave vjetore për disbursim për SECO-n nga Parlamenti Federal Zviceran.

3.3 Asnjë e ardhur e Kontributit nuk do të përdoret për qëllime të tjera, përveç veprimtarive të planifikuara në kuadër të Projektit.

3.4 Në zbatim të “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Federal Zviceran për bashkëpunimin teknik, financiar dhe humanitar”, të ratifikuar me ligjin nr. 9801, datë 13.9.2007; ligjin nr. 82/2022, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, fondet e përftuara për furnizimin e mallrave/shërbimeve nuk përdoren për pagesën e tatimeve dhe mallrat me destinacion realizimin e këtij projekti përjashtohen nga TVSH-ja mbi importin, pas lëshimit të Kodit Unik të Identifikimit (UIC) nga SASPAC

3.5 Çdo shumë e pashfrytëzuar e kontributit që mbetet pas përmbushjes së të gjitha detyrimeve, përkatësisht pas përfundimit të MP-së, sipas nenit 11, i kthehet SECO-s, përveç kur Palët Kontraktuese bien dakord reciprokisht ndryshe.

Neni 4

Kushtet e kontributit

4.1 Dispozitat e Marrëveshjes Kuadër gjejnë zbatim të plotë, përveç kur MP-ja përcakton dispozita të veçanta që nuk trajtohen nga përcaktimet e Marrëveshjes Kuadër. Në veçanti, MF-ja garanton kushtet e zbatimit të Projektit, sipas nenit 4 të Marrëveshjes Kuadër.

Neni 5

Organizimi i Projektit dhe përgjegjësitë e Palëve Kontraktuese

5.1 Ministria e Financave

Si partner i drejtpërdrejtë i Projektit, MF-ja ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e Projektit; bashkërenduar me bashkitë dhe autoritetet e tjera qeveritare të përfshira në veprimtaritë e Projektit, kur është e nevojshme; për të siguruar akses në informacionin përkatës, përfshirë edhe në të dhëna statistikore që çmohen të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektivave të Projektit. Informacioni përdoret vetëm për qëllimet e Projektit. Për përdorimin e tij për qëllime të tjera, duhet të merret pëlqimi paraprak me shkrim i MF-së. MF-ja mbështet dhe lehtëson zbatimin e Projektit, specifikisht:

- Duke u angazhuar aktivisht në veprimtaritë e Projektit, që lidhen me ndihmën që i ofrohet MF-së për të garantuar zbatimin e njëtrajtshëm të rregullave dhe procedurave të MFP-së në të gjitha bashkitë;

- Duke mbështetur dhe duke lehtësuar punën me bashkitë, kur është e mundur;
- Duke mbështetur dhe duke lehtësuar punën me palët e tjera të interesit që marrin pjesë në projekt, kur është e mundur.

5.2 Sekretariati Shtetëror për çështjet ekonomike SECO është autoriteti përgjegjës në emër të Qeverisë Zvicerane, dhe:

- ofron kontribut të parimbursueshëm në natyrë, siç përshkruhet në nenin 3;
- monitoron dhe mbikëqyr arritjen e rezultateve të Projektit siç janë renditur në Kuadrin Paraprak të Rezultateve (shtojca 2);

- autorizon individë dhe organizata të tjera vendore apo ndërkombëtare që të zbatojnë pjesë specifike të Projektit, si për shembull vlerësimin në përfundim të fazës.

5.3 Ambasada e Zvicrës në Shqipëri

Ambasada e Zvicrës përfaqëson SECO-n në Projekt, dhe:

- monitoron zbatimin e Projektit në terren;
- siguron komunikim të rregullt me bashkitë dhe autoritetet përkatëse të përfshira në Projekt;
- ndjek zhvillimet në sektorin e MFP-së në nivel vendor;
- përfaqëson SECO-n në Komitetin Drejtues, në mungesë të menaxherit të Programit të SECO-s.

5.4 Komiteti Drejtues

Komiteti Drejtues i Projektit (KDP) përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë të Ministrisë së Financave, përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, përfaqësues të Bashkive përkatëse, përfaqësues të SECO-s/Ambasadës Zvicerane në Tiranë, përfaqësues të SASPAC-ut dhe palë të tjera përkatëse interesi të identifikuar. KDP-ja ofron orientim strategjik për Projektin; miraton planet e punës dhe raportet gjashtëmujore të progresit. Agjencia Zbatuese vepron si Sekretariat i KDP-së. Komiteti Drejtues mbledhet të paktën dy herë në vit dhe bashkëkryesohet nga zëvendësministri i Financave përgjegjës për reformën e MFP-së në nivel vendor dhe SECO-ja, përfaqësuar nga menaxheri i Programit ose në mungesë, nga zëvendëshefi i Misionit të Ambasadës së Zvicrës. Rregullat dhe procedurat e funksionimit të Komitetit Drejtues përcaktohen në dokument të veçantë (Manuali operacional).

Neni 6

Prokurimi dhe Kontratat

6.1 Prokurimi lidhur me kontributin e SECO-s

6.1.1 Në lidhjen e kontratave me nënkontraktuesit, Agjencia Zbatuese zbaton dispozitat e Aktit Federal Zviceran Për Prokurimin Publik (APP) dhe Urdhëresës për Prokurimin Publik (UPP).

6.1.2 Procedurat e ankimit nuk gjejnë zbatim. E drejta e dëmshpërblimit përjashtohet.

6.1.3 Mallrat e siguruara me fonde të SECO-s për përdorim në Projekt mbeten në dispozicion të pakufizuar të Projektit gjatë gjithë Projektit dhe nuk devijohen nga Projekti pa miratimin paraprak me shkrim të SECO-s.

6.1.4 Nëse Projekti duhet të ndërpritet për çfarëdolloj arsyeje, përdorimi i mallrave të siguruara me kontributin zviceran menaxhohet sipas diskrecionit të SECO-s. Në fund të Projektit, SECO-ja vendos lidhur me pronësinë dhe përdorimin e mallrave të prokuruar në kuadër të Projektit.

6.2 Auditimi dhe vlerësimi financiar

6.2.1. Agjencia Zbatuese dorëzon auditim financiar sipas Politikës së Auditimit Financiar të SECO-s, të ndryshuar, çdo vit.

6.2.2. Në periudhën e fundit të zbatimit të Projektit ndërmerret një vlerësim i jashtëm i tij.

Neni 7

Zbatimi i Projektit

7.1 Parimi udhëheqës i zbatimit të projektit është që anëtarët e të gjitha organeve të përfshira të përpiqen gjithmonë të veprojnë në frymën e bashkëpunimit dhe të marrin vendime me konsensus. Kur dhe nëse lind nevoja, Palët Kontraktuese, me kërkesë të njëres prej Palëve:

- shkëmbejnë pikëpamje lidhur me përmbushjen e detyrimeve të tyre përkatëse, në kuadër të MP-së, administrimin e kontributit dhe operacioneve të financuara nga kontributi;

- i ofrojnë Palës tjetër Kontraktuese të gjitha informacionet që ajo i kërkon në mënyrë të arsyeshme lidhur me ekzekutimin e kontributit dhe operacionet e financuara nga kontributi.

7.2 Palët Kontraktuese e informojnë në kohë njëra-tjetrën për çdo situatë që ndërhyt ose mund të ndërhyjë në arritjen e qëllimit të kontributit ose në përmbushjen e detyrimeve të tyre përkatëse në kuadër të MP-së.

7.3 Palët Kontraktuese mbajnë dokumentacionin dhe dosjet e tyre përkatëse lidhur me ekzekutimin e Projektit dhe përdorimin e kontributit. Ato i ruajnë të gjitha dokumentet lidhur me MP-në dhe zbatimin e saj deri në dhjetë vjet pas përfundimit të Projektit.

7.4 SECO-ja mund të organizojë në çdo kohë misione shqyrtimi për të garantuar zbatimin efikas të Projektit dhe përdorimin e kontributit, si dhe arritjen e objektivave të tij.

Neni 8

Dispozita kundër korrupsionit

Palët Kontraktuese ndajnë shqetësim të përbashkët lidhur me luftën kundër korrupsionit, i cili rrezikon qeverisjen e mirë dhe përdorimin e duhur të burimeve të nevojshme për zhvillim dhe, për më tepër, rrezikon konkurrencën e drejtë dhe të hapur të bazuar në çmim dhe në cilësi. Si rrjedhojë, Palët Kontraktuese deklarojnë synimin e tyre për të bashkuar përpjekjet për të luftuar korrupsionin dhe, në veçanti, deklarojnë se çdo ofertë, dhuratë, pagesë, shpërblim ose përfitim i çdo lloji, i bërë nga cilido, ose i pranuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me qëllimin dhënien e një tagri ose kontrate në kuadër të MP-së, ose gjatë ekzekutimit të saj, interpretohet si veprim i paligjshëm ose praktikë korrupsioni. Çdo akt i këtij lloji përbën bazë të mjaftueshme për ndërprerjen e kësaj MP-je, prokurimit ose kontratës përkatëse, ose për marrjen e çfarëdolloj mase tjetër korrigjuese të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Palët informojnë në kohë njëra-tjetrën për çdo dyshim të mundshëm për korrupsion.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshjeje, dallim në qëndrim dhe/ose konflikt që lind nga interpretimi dhe/ose zbatimi i dispozitave të kësaj MP-je, zgjidhet me negociata diplomatike ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Neni 10

Modifikimet ose ndryshimet, shtojcat

10.1 Çdo modifikim ose ndryshim i MP-së dhe i shtojcave nga Palët Kontraktuese, në kuadër të MP-së, bëhet vetëm me shkrim dhe bazuar në marrëveshje me konsensus ndërmjet Palëve Kontraktuese. Dokumentacioni i miratuar në këtë formë bëhet pjesë e pandashme e kësaj MP-je dhe hyn në fuqi nga data e nënshkrimit më të fundit.

10.2 Shtojcat e mëposhtme janë pjesë integrale e kësaj MP-je:

Shtojca 1: Përshkrimi i Projektit

Shtojca 2: Kuadri paraprak i rezultateve të Projektit

Neni 11

Hyrja në fuqi dhe ndërprerja

11.1 MP-ja hyn në fuqi pas përfundimit të procedurave të brendshme. Ajo mbetet në fuqi deri në përmbylljen e të gjitha detyrimeve të ndërmarra në kuadër të saj, por jo pas datës 30 prill 2029.

11.2 Secila Palë Kontraktuese ka të drejtë të ndërpresë MP-në në çdo moment mbi bazën e një njoftimi me shkrim gjashtë muaj para.

11.3 Pavarësisht nga sa më sipër, secila Palë Kontraktuese, me njoftim me shkrim, mund të ndërpresë MP-në me efekt të menjëhershëm, në rast të shkeljes së rëndë të MP-së. Shkelja e rëndë është shkelje serioze e një prej objektivave thelbësorë të MP-së, ose shkelje serioze e detyrimeve të Palëve Kontraktuese (p.sh. Klauzolës kundër Korrupsionit, neni 8).

11.4 Në rast të ndërprerjes së MP-së, sipas nenit 11 paragrafi 2, dispozitat e MP-së do të vazhdojnë të zbatohen për të gjitha kontratat në zbatim e sipër në momentin e ndërprerjes së saj deri në përfundimin e kontratave përkatëse.

Neni 12

Gjuha

E gjithë korrespondenca me SECO-n, duke përfshirë të gjitha dokumentet, miratime faturash, raporte apo dokumente të tjera të lidhura me projektin, hartohen në gjuhën angleze.

Neni 13

Përgjegjësia

Qeveria Zvicerane nuk merr përsipër asnjë detyrim apo përgjegjësi për dëme, dëmtime, lëndime ose ndikime të tjera të mundshme negative që rrjedhin nga Projekti, duke përfshirë por pa u kufizuar në mospërputhjet gjatë planifikimit të vetë Projektit apo ndonjë Projekti tjetër që mund ta ndikojë ose të shkaktojë pakënaqësi publike.

Neni 14

Dispozita të veçanta

Me qëllim garantimin e vizibilitetit të kontributit, të gjitha materialet e marrëdhënieve me publikun dhe i gjithë dokumentacioni i hartuar në kuadër të Projektit citon faktin se Projekti financohet nga Konfederata Zvicerane dhe shfaq logon e Konfederatës Zvicerane.

Lidhur në Tiranë, më _____ hartuar në dy kopje origjinale për secilën gjuhë, në gjuhët angleze dhe shqipe. Në rast mospërputhjeje gjatë interpretimit, ose zbatimit të dispozitave të MP-së, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Ministrinë e Financave

Petrit Malaj

Ministër

Ministër i Financave

Për Sekretariatën Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike

Ruth Huber

Ambasadore

Ambasada e Zvicrës në Shqipëri

SHTOJCA 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT

Faza 2 e Projektit është plotësisht në përputhje me përparësitë e Qeverisë Shqiptare.

MFP-ja vendore ishte pjesë përbërëse e Strategjisë së mëparshme të Qeverisë për MFP-në (2019–‘22) dhe do të vazhdojë të jetë pjesë edhe në strategjinë e ardhshme (2023–‘30), aktualisht në hartim e sipër. Faza II pritët të japë kontribut të ndjeshëm në arritjen e objektivave të Strategjisë së re, veçanërisht në lidhje me: i. zbatimin e sistemit unik të buxhetit në të gjitha institucionet publike; ii. reduktimin e detyrimeve të prapambetura buxhetore të përgjithshme; dhe iii. standardizimin e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit. Faza II është, gjithashtu, e harmonizuar me Strategjinë për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030, në lidhje me shtyllat e “shtimit të autonomisë financiare” dhe të “përmirësimit të ofrimit të shërbimeve publike vendore”.

Projekti është vijim i Projektit “Forcimi i MFP-së Vendore në Shqipëri” (faza 1). Ky është projekt dypalësh i zbatuar nga GFA Consulting Group. Qëllimi i tij është përmirësimi i situatës së MFP-së në nivel vendor në Shqipëri, duke forcuar disiplinën financiare, duke rritur efikasitetin e përdorimit të burimeve publike dhe duke përmirësuar ofrimin e shërbimeve vendore; duke u garantuar në këtë mënyrë qytetarëve akses në shërbime publike më të mira dhe me efikasitet në kosto. Projekti funksionon si në nivel vendor me bashkitë dhe në nivel qendror me MF-në, për të lehtësuar dialogun mbi politikat. **Projekti ka si objekt ofrimin e asistencës teknike dhe ngritjen e kapaciteteve për bashkitë dhe organet homologe në nivel qendror.** Logjika e ndërhyrjes me të cilën Projekti kontribuon për këtë objektiv, mund të përmbledhet si më poshtë: “Mbështetja e drejtpërdrejtë, e siguruar nga Projekti dhe shkëmbimi i njohurive ndërmjet bashkive në fushat kryesore të MFP-së, do t’u mundësojë 61 bashkive që të përmirësojnë kapacitetin dhe sistemet e tyre të MFP-së, dhe rezultati do të jetë disiplinë më e mirë financiare, përdorim më efikas i burimeve publike dhe përmirësim i ofrimit të shërbimeve në nivel vendor”. Projekti do të synojë të arrijë bashkërendim ndërmjet donatorëve, me qëllim shfrytëzimin sa më të mirë të instrumenteve, njohurive dhe kapaciteteve tashmë të disponueshme.

Organizimi dhe përgjegjësia për Projektin

Si partner i drejtpërdrejtë i Projektit, MF-ja ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e Projektit; bashkërenduar bashkitë dhe autoritetet e tjera qeveritare të përfshira në veprimtaritë e Projektit, kur është e nevojshme; siguruar qasje në informacionin përkatës, duke përfshirë të dhënat statistikore të nevojshme dhe të dobishme për përmbushjen e objektivave të Projektit.

Në rolin e partnerëve të tjerë të drejtpërdrejtë të Projektit, 61 bashkitë kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për krijimin e mjedisit të favorshëm për zbatimin e Projektit. Ato do të sigurohen që stafi i tyre përkatës përgjegjës për MFP-në në nivel vendor në administratën bashkiake, të jetë i disponueshëm dhe të marrë pjesë në Projekt, si dhe të përmbushë detyrat që rrjedhin nga Projekti në momentet përkatëse.

Në emër të Konfederatës Zvicerane, Agjencia Zbatuese merr përsipër të gjitha detyrat operacionale, administrative dhe mbikëqyrëse të Projektit, duke përfshirë disbursimet, monitorimin dhe raportimin. Agjencia Zbatuese është përzgjedhur me procedurë tenderimi të hapur publik ndërkombëtar.

Si autoritet përgjegjës, donatori (Konfederata Zvicerane) ka përzgjedhur SECO-n, i cili monitoron arritjet e rezultateve të Projektit dhe mund të autorizojë individë të tjerë, si dhe organizata vendore apo ndërkombëtare për zbatimin e pjesëve specifike të Projektit, si, për shembull, vlerësimin në fund të fazës.

Ambasada e Zvicrës përfaqëson SECO-n në Projekt, mbikëqyr Projektin dhe ndjek nga afër zhvillimet në sektorin e MFP-së në nivel vendor.

Komiteti Drejtues i Projektit (KDP) përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë të MF-së dhe të bashkive, përfaqësues nga SECO/Ambasada Zvicerane në Tiranë, përfaqësues nga SASPAC-u dhe palë të tjera përkatëse interesi të identifikuar. KDP-ja ofron orientim strategjik për Projektin; miraton planet e punës dhe raportet gjashtëmujore të progresit. Agjencia Zbatuese vepron si Sekretariat i KDP-së. Komiteti Drejtues mbledhet të paktën dy herë në vit dhe bashkëkryesohet nga zëvendësministri i Financave, përgjegjës për reformën e MFP-së në nivel vendor dhe SECO-ja, përfaqësuar nga menaxheri i Programit, ose në mungesë, nga zëvendëshefi i Misionit në Ambasadën e Zvicrës. Rregullat dhe procedurat e funksionimit të Komitetit Drejtues përcaktohen në dokument të veçantë (Manuali operacional).

Veprimtaritë dhe rezultatet e pritshme të Projektit

Komponentët dhe veprimtaritë përkatëse grupohen më poshtë, si bazë për shtjellim të mëtejshëm të veprimtarive nga ana e AZ-së. Faza II do të nisë me një periudhë përgatitore njëmujore, me qëllim përcaktimin e një baze të mirë fillestare për vlerësimin dhe për monitorimin.

Faza përgatitore synon të detajojë rezultatet e pritshme për planin e parë njëvjeçar të punës, të shqyrtojë progresin e arritur deri me tani mbi zbatimin e softuerit të ri përmes internetit për planifikimin e buxhetit dhe shtjellimin e udhërrëfyesit për zbatimin në shkallë të gjerë të procedurës së re të buxhetit. Ndërkohë, zbatimi i veprimtarive të Projektit do të vijojë të sigurojë kalim të qetë nga njëra fazë tek tjetra.

Komponenti 1: Mbështetje për bashkitë në përmirësimin e kapaciteteve dhe të sistemeve të MFP-së

Ky përfaqëson komponentin më intensiv të Projektit, për sa u përket burimeve. Fushat e ndërhyrjes mund të klasifikohen në tre nënkomponentë, si më poshtë.

- Nënkomponenti 1: Planifikimi strategjik dhe menaxhimi i buxhetit

Rezultati kryesor i këtij nënkomponenti është përmirësimi i planifikimit strategjik dhe i administrimit të përgjithshëm të buxhetit në 61 bashkitë. 9 bashki (3 për buxhetin 2022–'23, 6 për buxhetin 2023–'24) kanë zbatuar tashmë një procedurë të re buxhetore me mbështetjen e Projektit, të miratuar paraprakisht nga MF-ja. Kjo procedurë përfshin udhëzime për bashkitë lidhur me planifikimin, ekzekutimin dhe monitorimin e buxhetit, duke përfshirë planifikimin buxhetor afatmesëm.

Me kërkesë të Qeverisë, Projekti po zhvillon një softuer të bazuar në internet, me qëllim që bashkitë të përgatitin planin e tyre buxhetor afatmesëm. Programi ka synimin të veprojë si urë ndërmjet sistemit aktual (kryesisht i bazuar në *Excel*) dhe zbatimit të AFMIS-it në nivel vendor.

Pilotimi dhe testimi janë planifikuar për tremujorin e 3-të të vitit 2023 dhe tremujorin parë të vitit 2024. Sfidat që mund të lidhen me përdorimin e programit dhe qëndrimi i Qeverisë lidhur me programin do të shërbejnë për strategjinë e shtrirjes për fazën II (shihni paragrafin vijues).

Shtrirja e mbështetjes në të gjitha bashkitë do të bazohet në përvojat e trajnimit me 9 bashkitë pilot për procedurën e re buxhetore të organizuar gjatë fazës I. Pritet që MF-ja t'i qaset me kujdes shtrirjes në vitin 2024, për shkak të pasigurive që lidhen me përdorimin e softuerit të ri. Shtrirja e shpejtë dhe intensive parashikohet të fillojë nga viti 2025 e në vijim, duke kombinuar dy forma kryesore të ndihmës: i. mbështetje intensive e vazhdueshme për një numër të kufizuar bashkish çdo vit; dhe ii. veprimtari më të përgjithshme për zhvillimin e kapaciteteve që përfshijnë bashkitë që tashmë e përdorin sistemin e reformuar buxhetor dhe bashkitë e tjera.

- Nënkomponenti 2: Menaxhimi i të ardhurave

Rezultati kryesor i këtij nënkomponenti është forcimi i sistemeve vendore të menaxhimit të të ardhurave vendore, duke u mundësuar bashkive që të rrisin të ardhurat nga burimet e veta.

Puna në këtë fushë synon të rrisë autonominë financiare të bashkive dhe të ulë varësinë e tyre nga transfertat e qeverisjes qendrore. Faza II do të bazohet në rezultatet e arritura në fazën I dhe do të përqendrohet në mbështetjen e bashkive për pikat e mëposhtme: i. forcimin e kapaciteteve të tyre për parashikimin e saktë të të ardhurave e tyre dhe përgatitjen e paketave fiskale bashkiake; ii. rritjen e gatishmërisë së tyre për zbatimin e një ligji të ri për tatimin mbi pasurinë e

paluajtshme; iii. konsolidimin e sistemit e tyre të mbikëqyrjes dhe të menaxhimit të mbledhjes së tatimeve; dhe iv. zgjerimin e mëtejshëm të bazës tatimore.

- Nënkomponenti 3: Kontrolli i brendshëm, auditimi i brendshëm dhe raportimi financiar

Rezultati kryesor i këtij nënkomponenti është ngritja e sistemeve të efektshme të kontrollit të brendshëm, auditimit të brendshëm dhe raportimit financiar në nivel vendor. Në vijim të rezultateve të arritura në fazën I, faza II do të përqendrohet në: i. zbatimin e menaxhimit të integruar bazuar në risk dhe instrumentet e përshtatshme të monitorimit dhe të vlerësimit në sistemin e kontrollit të brendshëm; ii. forcimin e mëtejshëm të funksionit të auditimit të brendshëm, me qëllim që bashkitë të përmbushin plotësisht udhëzimet e qeverisjes qendrore; dhe iii. ngritjen e një sistemi të qëndrueshëm dhe të efektshëm të raportimit financiar për të siguruar informacion për vendimmarrjen.

Komponenti 2: Nxitja e shkëmbimit të njohurive mbi MFP-në ndërmjet bashkive dhe fuqizimi i menaxhimit të ndryshimit dhe të kompetencave të udhëheqjes

Rezultati i këtij komponenti është forcimi i shkëmbimit të njohurive ndërmjet bashkive dhe përmirësimi i aftësive të udhëheqjes dhe menaxhimit të ndryshimit. Faza 1 ka hedhur tashmë bazat për krijimin e një kuadri për menaxhimin e njohurive për MFP-në në nivel vendor, si dhe krijoi instrumente të reja (si platformën elektronike që do të mirëmbahet nga MF-ja, dhe që është ideuar si bibliotekë njohurish për bashkitë).

